



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 maj 2014
Nr. ref.: RK638/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI210/13

Parashtrues

Haxhi Morina

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit Ankimore të
Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme, AC-II-12-0108,
të 10 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa u dorëzua nga z. Haxhi Morina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), me vendbanim në Gjakovë, i cili përfaqësohet nga z. Rexhep Gjikolli, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin AC-II-12-0108, të Kolegjit Ankimor të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Koleksi Ankimor i Dhomës së Posaçme), të 10 tetorit 2013, i cili iu dorëzua atij më 14 tetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se aktgjykimi i lartpërmendur ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), gjegjësisht me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], si dhe të drejtat e tij pronësore, të garantuara me nenin 17.2 të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-131 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 19 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI210/13, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegin shqyrties, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 11 dhjetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin Ankimor të Dhomës së Posaçme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 23 janar 2014, Kolegi shqyrties pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Rasti i mëparshëm i parashtruesit në Gjykatë

9. Më 27 nëntor 2012, Gjykata Kushtetuese, në rastin e mëparshëm të parashtruesit, Rasti Nr. KI68/12, shpalli kërkesën e tij për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës, A. nr. 313/2009, të 26 marsit 2012, si të papranueshme.
10. Në atë rast, parashtruesi pretendoi se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë. Në këtë drejtim, Gjykata gjeti se parashtruesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjit të zbatueshëm, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit, sepse rasti ishte në procedurë në Dhomën

e Posaçme. Procedura në fjalë kishte përfunduar me nxjerrjen e Aktgjykimit AC-II-12-0108, të Kolegit Ankimor të Dhomës së Posaçme, të cilin parashtruesi e konteston në rastin konkret.

Përbledhja e fakteve

11. Më 7 maj 1981, Sekretariati për Ekonomi dhe Financa në Komunën e Gjakovës, me Aktvendimin 03-465-26/1978, eksproprijoi pronën e paluajtshme të parashtruesit (me sipërfaqe prej 0,89.64 ha) për nevojat e SH. A. M. "Mustafa Bakija". Në përputhje me këtë aktvendim, kjo pronë e paluajtshme ishte regjistruar në kadastër në emër të SH. A. M. "Mustafa Bakija," në Gjakovë. Ky vendim u bë i plotfuqishëm më 5 mars 1982.
12. Parashtruesi e kontestoi aktvendimin për eksproprijim në Gjykatën Supreme të Kosovës. Sidoqoftë, më 3 mars 1982, Gjykata Supreme hodhi poshtë padinë e tij.
13. Më 2 mars 1984, parashtruesit iu ofrua kompensimi monetar në shumë prej 627.480 dinarësh. Ai refuzoi kompensimin monetar, duke deklaruar: "*Nuk do të pajtohem të nënshkruaj pa më dhënë tokë tjetër.*" Pasi që marrëveshja për kompensim nuk ishte arritur në procedurën administrative, çështja e kompensimit iu referua gjykatës kompetente.
14. Përkundër faktit se Aktvendimi për eksproprijim i 7 majit 1981 u bë i plotfuqishëm, prona e paluajtshme e ekspropriuar nuk ishte shfrytëzuar për destinimin e caktuar, d.m.th.: për të ndërtuar një poligon për ushtrime praktike të shoferëve dhe të autobusëve.
15. Në këtë drejtim, parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se "... *në vitin 1984, edhe pse kishte kërkuar ndihmën e policisë të merr posedimin faktik në këtë paluajtshmëri, nuk ka pasur sukses, pasi që parashtruesi me familje e kishte mbjellë këtë ngastër me duhan dhe kjo mënyrë e shfrytëzimit ka vazhduar deri më tanë*".
16. Më 12 korrik 1994, parashtruesi parashtroi kërkesë në Drejtoren e Çështjeve Juridike dhe Pronësore dhe të Konsolidimit të Tokës në Komunën e Gjakovës, duke kërkuar kthimin e pronës së paluajtshme, sepse SH. A. M. "Mustafa Bakija" asnjëherë nuk e ka shfrytëzuar pronën për qëllimin për të cilin ishte ekspropriuar.
17. Më 11 maj 2006, parashtruesi inicioi një procedurë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, duke kërkuar që të konfirmojë pronësinë mbi pronën e paluajtshme të kontestuar.
18. Më 24 tetor 2006, Dhoma e Posaçme nxori një Vendim (SCC-06-0214), me ç'rast padia kundër SH. A. M. "Mustafa Bakija" ishte referuar në Komunën e Gjakovës për gjykim.
19. Më 25 nëntor 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë nxori Aktgjykin C. nr. 700/06 dhe hodhi poshtë padinë e parashtruesit si të pabazuar.

20. Në arsyetim, Gjykata Komunale theksoi, ndër të tjera, se kërkesa e parashtruesit për kthimin e pronës ishte dorëzuar jashtë afatit prej dhjetë (10) vitesh të parashkrimit.
21. Më 29 qershor 2011, parashtruesi ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Dhomën e Posaçme. Në ankesë, parashtruesi pretendonte se aktgjykimi i kontestuar përbante shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 10 tetor 2013, Kolegji Ankimor i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin e kontestuar, AC-II-12-0108, me të cilin u refuzua ankesa e parashtruesit të kërkesës si e pabazuar. Rrjedhimisht, ishte vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë, i 24 nëntorit 2010.
23. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, ndër të tjera, ishte përmendur, “... *Ish-pronari nuk është pajtuar me eksproprijimin gjatë tërë procedurës së eksproprijimit dhe kishte vazhduar ta kundërshtojë atë. Kulminacionin e shprehjes së tij negative ai e ka arritur me datën 15 qershor 1984 në zyrë... kur tha se nuk do ta dorëzojë tokën pa u bërë dikush kurban aty ...*”. Më tutje u theksua se “*Rezistenca e paditësit vërtetë të detyron që të mendosh seriozisht t'ia njohësh të drejtën për kthimin e pronës kontestuese në pronësi dhe posedim. Megjithatë, në këtë rast ligji është determinuesi kryesor për marrjen e një vendimi të tillë. Ligji është ai që përcakton kriteret dhe kushtet, se si dhe kur ish-pronari do të kërkojë anulimin e një vendimi përfundimtar për shpronësimin dhe rifitim të së drejtës së tij në pronën e shpronësuar*”.
24. Kolegji Ankimor i Dhomës së Posaçme saktësoi më tej se sipas nenit 21.3 të Ligjit për eksproprijim, parashtruesi kishte të drejtë të kërkojë anulimin e vendimit përfundimtar për eksproprijim brenda tri (3) viteve nga data e mospërbartimit të vendimit.
25. Më tej, theksohet se në pajtim me nenin 21.4 të Ligjit, “*pas skadimit të 10 viteve nga dita kur vendimi ishte bërë i plotfuqishëm, nuk mund të bëhet asnjë kërkesë për anulimin e atij vendimi*”. Përfundimisht, Kolegji Ankimor konkludoi se “... *nëga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi deri më 1994, kanë kaluar më shumë se 12 vite, prandaj padia e paditësit refuzohet si e pabazuar në ligj, ndërsa aktgjykimi i ankimuar duhet të vërtetohet*”.

Pretendimet e parashtruesit

26. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është marrë në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]. Ai gjithashtu pretendon se është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 17.2 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.
27. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit për tokën ndërtimore. Ai më tej argumenton se në rastin e tij nuk duhet të zbatohet Ligji mbi eksproprijimin, por Ligji për tokën ndërtimore. Ai argumenton më tej se prona e tij asnjëherë

nuk ishte shpronësuar dhe për këtë arsyё çështja në fjalë duhet të konsiderohet si "*deposedim*." Në mbështetje të pretendimit të tij, parashtruesi pohon se ai kurrë nuk është kompensuar.

28. Parashtruesi argumenton më tej se ka pasur shkelje të parimit të "*barazisë së armëve*", pasi që parashkrimi prej dhjetë (10) vitesh duhet të jetë i zbatueshëm në mënyrë të barabartë për të dy palët në procedurë.
29. Gjkata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari që të vlerësojë nëse ai i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
30. Nga pohimet e parashtruesit, të përbledhura si më lart, shihet qartë se parashtruesi i kërkesës thjesht konteston nëse Kolegji Ankimore i Dhomës së Posacme e ka zbatuar drejt ligjin e zbatueshëm. Parashtruesi më tej nuk pajtohet me gjetjet faktike të Gjkatës Supreme në lidhje me rastin e tij.
31. Në këtë drejtim, Gjkata vëren se parashtruesi i kërkesës ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të përcaktuara me Ligjin për procedurën kontestimore dhe se Kolegji Ankimore i Dhomës së Posacme ka marrë parasysh dhe iu është përgjigjur ankesave të tij në çështjet e ligjit.
32. Gjkata rikujton se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjkata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I, shih gjithashtu edhe Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin Nr. KI70/11, parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjkatës Supreme, A. nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011).
33. Gjkata më tej vëren që fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrëjë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, kërkesa nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, e 26 korrikut 2005).
34. Rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, e cila përcakton se "*Gjkata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar*".

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 23 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrta e Gjykatës Kushtetuese në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snejhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani